
KONCEPTI

PËR ARSIMIN INKLUZIV

Shkup, 2020

Koncepti për arsimin gjithëpërfshirës u përgatit nga një grup pune i formuar nga u.d. drejtori i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, Zeqirija Hasipi. Filomena Pereira nga Portugalia dhe Ljiljana Simić nga Serbia me përvojën e tyre të pasur në fushën e përfshirjes ofruan një bazë solide për zhvillimin e konceptit nga grupi i punës i përbërë nga:

Bashkërendues i grupit të punës:

Mr. Snezhana Trpevska, Byroja e zhvillimit të arsimit;

Anëtarë:

Natasha Jankovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

Biljana Trajkovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

Elena Ivanovska, Ministria e Arsimit dhe Shkencës;

Mr. Zhaneta Çonteva, Byroja e zhvillimit të arsimit;

Mr. Lidija Dojčinovska, Kabineti i kryeministrit të RMV;

Spase Dodevski, Kabineti i Kryeministrit të RMV;

Prof. dr. Jasmina Delceva Dizdarevic, Instituti i Pedagogjisë,
Fakulteti Filozofik, Shkup;

Prof. Olivera Rashiç Canevska, Instituti për Edukim Special
dhe Rehabilitim, Fakulteti Filozofik, Shkup;

Prof. dr. Orhideja Shurbanovska, Instituti i Psikologjisë,
Fakulteti Filozofik, Shkup;

Andrijana Tasevska, Shkolla Filllore „Krume Kepeski” -Shkup;

Marija Deletiq „SHFP „Zlatan Sremac” - Shkup dhe

Goran Petrushev, Unioni i edukatorëve speciale
dhe rehabilituesit të RM së Veriut.

Arsimi inkluziv ose gjithëpërfshirës është një proces që plotëson dhe u përgjigjet nevojave të ndryshme të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve duke siguruar qasje, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në mësimnxënie, në shkollë dhe në komunitet. Ai përfshin përshtatjen e arsyeshme të përmbajtjes arsimore, qasjet dhe strategjitë e duhura të mësimdhënies, si dhe organizimin e procesit edukativo- arsimor në përgjithësi, në mënyrë që të sigurojë arsim cilësor për të gjithë. Arsimi inkluziv do të thotë që të gjithë fëmijët të përfshihen dhe pranohen, me vëmendje të veçantë ndaj fëmijëve që mund të jenë të marginalizuar, diskriminuar ose përjashtuar nga sistemi arsimor. Ata, pavarësisht nga dobësitë e tyre në disa fusha, dhe sipas potencialit të tyre, përfshihen në klasat e rregullta dhe u sigurohen kushte të përshtatshme për të mësuar, avancuar dhe pjesëmarrje në jetën shkollore.

Duke pasur parasysh që arsimi inkluziv ka specifikat e veta në vendosjen e sistemit, në përmbajtjen dhe organizimin e veprimtarisë arsimore, Ligji për arsimin fillor parashikon përgatitjen e një dokumenti të veçantë - Koncepti për arsimin inkluziv, i cili duhet të japë udhëzime specifike se si arsimi inkluziv do të zbatohet në praktikë në sistemin tonë shoqëror.

Koncepti propozon masa dhe strategji për të hequr pengesat për zbatimin e arsimit inkluziv dhe qëndrueshmërinë e tij. Në këtë kuptim, është e rëndësishme që secila shkollë të jetë në gjendje të njohë vlerën e ndryshimeve të nxënësve të saj, të gjejë mënyra për t'i respektuar ato, për t'i përshtatur mësimdhënies të karakteristikave individuale të secilit

nxënës, për të rritur dhe mobilizuar burimet ekzistuese në dispozicion të saj, në mënyrë që secili nxënës të mësojë dhe të marrë pjesë në jetën e përgjithshme shkollore.

Në rastet kur identifikohen vështirësi më të mëdha për pjesëmarrje në procesin arsimor, secila shkollë duhet të identifikojë pengesat e mësimnxënies me të cilat përballet nxënësi dhe të ofrojë strategji të përshtatshme për t'i tejkaluar ato. Kjo i lejon secilit nxënës të ketë qasje në mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe pjesëmarrje dhe arritje në përputhje me potencialin e tyre.

I. NEVOJA DHE PËRFSHIRJA E KONCEPTIT

Edrejta e të gjithë fëmijëve për arsim është e regjistruar në një numër marrëveshjesh dhe dokumentesh ndërkombëtare dhe konfirmohet nga një numër instrumentesh ligjërish të detyrueshme dhe jo-detyruese. Prandaj, shtetet kanë detyrimin të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtën e të gjithë nxënësve për arsimim.

Arsimi inkluziv bazohet në qasjen e themeluar në të drejtat e njeriut të përcaktuar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, të cilat pranohen nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Korniza e veprimit të arsimit 2030 e miratuar nga komuniteti global i arsimit¹, për të përmirësuar avancimin drejt qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm në Objektivin 4: **Të sigurojë arsim inkluziv dhe me cilësi të barabartë dhe të promovojë mundësi për të mësuar gjatë gjithë jetës**, thekson nevojën për të zgjidhur të gjitha format e përjashtimit dhe marginalizimit. Më konkretisht, bëhet thirrje për zgjidhjen e pabarazive në lidhje me qasjen, pjesëmarrjen, proceset dhe rezultatet e mësimnxënies, me një fokus në barazinë gjinore.

Në vëzhgimet përfundimtare të Komitetit të Kombeve të Bashkuara (KB) për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në lidhje me

¹ United Nations. 2015. Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development. Në dispozicion: <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld>.

raportin fillestar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në shtator 2018², ndër të tjera, u bë një rekomandim për të rishikuar Ligjin për arsimin fillor, në mënyrë që të promovojë qartë arsimin inkluziv dhe të ndalojë diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar. Sipas rekomandimeve, në Ligjin për arsimin fillor, miratuar në gusht 2019³, theksohet se arsimi fillor është institucionalisht, kadrovik dhe përmbajtësor i organizuar në një mënyrë që mbështet inkluzionin (përfshirjen) e të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt fillor. Ligji ndalon diskriminimin për çfarëdo baze në të gjitha fushat e funksionimit të shkollës fillore, ndërsa personeli i shkollës fillore është i përkushtuar për të promovuar barazinë dhe drejtësinë midis të gjithë nxënësve dhe për të kundërshtuar në mënyrë aktive të gjitha format e diskriminimit dhe dhunës.

Duke pasur parasysh që arsimi inkluziv merr parasysh nevojat individuale për zhvillimin e nxënësve, duke siguruar mundësi të barabarta për realizimin e të drejtave themelore të njeriut për zhvillim dhe arsim cilësor, Koncepti për arsimin inkluziv ofron udhëzime për përfshirjen, zhvillimin dhe edukimin e grupeve vijuese të nxënësve me nevojat e veçanta arsimore (NVA):

▶	nxënësit me aftësi të kufizuar - të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore dhe të cilët, në bashkëveprim me pengesa të ndryshme shoqërore, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në një bazë të barabartë me të tjerët;
▶	nxënësit me çrregullime të sjelljes ose probleme emocionale ose me vështirësi specifike në të mësuar;
▶	nxënësit nga mjedise të pafavorshme socio-ekonomike, kulturore dhe / ose gjuhësore të privuara,
▶	nxënësit me nevoja komplekse - të cilët kanë vështirësi të shumëfishta, çrregullime të shumëfishta, nevoja komplekse shëndetësore dhe nevojë për ndihmë dhe mbështetje të madhe dhe intensive ⁴ ,

² Concluding observations on the initial report of the former Yugoslav Republic of Macedonia. Në dispozicion: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/concluding_observation_2018_committee_on_the_rights_of_persons_with_disabilities.pdf

³ Ligji për arsimin fillor: Gazeta zyrtare e RMV, nr. 161 më 5.8.2019

⁴ Novak, M. i Zhizhak, A. (2016). Pojam i ključna obilježja kompleksnih intervencija za populaciju u riziku. Достапно на: https://www.researchgate.net/publication/328896245_Pojam_i_ključna_obilježja_kompleksnih_intervencija_za_populaciju_u_riziku

▶	nxënësit me shtetësi të huaj, fëmijë pa shtetësi, fëmijë refugjatë, azilkërkues, fëmijë me status të njohur refugjati, fëmijë nën mbrojtje plotësuese, fëmijë nën mbrojtje të përkohshme të cilët qëndrojnë në vendin tonë,
▶	nxënësit të cilët nuk janë përfshirë në mësimdhënie dhe janë mbi moshën dhe
▶	nxënësit nga kategoritë e tjera të prekshme të cilat për arsye të ndryshme kërkojnë mbështetje dhe kujdes të veçantë gjatë procesit arsimor.

II. VIZIONI DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

VIZIONI

Vizioni për arsimin inkluziv nënkupton që secilit fëmijë, pavarësisht nga mosha, gjinia, orientimi seksual, raca, origjina etnike, feja ose besimi, aftësia, origjina socio-ekonomike, siguron mundësitë e arsimit cilësor me bashkëmoshatarët e tyre, në kuadër të sistemit të rregullt edukativo - arsimor, që nga mosha e hershme dhe gjatë gjithë jetës.

PARIMET UDHËRRËFYESE NË ARSIMIN INKLUZIV

- ▶ Gatishmëria universale për arsim do të thotë që të gjithë fëmijët dhe nxënësit mund të mësojnë, zhvillohen, arrijnë dhe kontribuojnë në komunitet dhe shoqëri në përgjithësi.
- ▶ Drejtësi, ose një garanci që të gjithë fëmijët dhe nxënësit të kenë qasje në mbështetjen e nevojshme për të realizuar potencialin e tyre për mësim dhe zhvillim.
- ▶ Inkluzioni është e drejta e të gjithë fëmijëve dhe nxënësve për qasje dhe pjesëmarrje, në mënyrë efektive dhe të plotë, në kontekstin e përbashkët edukativo-arsimor.
- ▶ Organizimi i procesit edukativo-arsimor sipas përmasave të nxënësit, ku lloji i mbështetjes vendoset individualisht për secilin nxënës sipas potencialit, nevojave dhe interesave të tij..
- ▶ Fleksibiliteti - organizim fleksibël i planit mësimor, programit mësimor, hapësirës shkollore dhe kohës, për të mundësuar procesin edukativo-arsimor duke aplikuar metoda dhe aktivitete të përshtatshme mësimore për t'iu përgjigjur specifikave dhe stileve të mësimnxënies të secilit nxënës/nxënëse.
- ▶ Vetëvendosja - respektimi i pavarësisë personale, duke marrë parasysh nevojat, interesat dhe aftësitë e nxënësve, identitetin kulturor dhe gjuhësor, duke krijuar mundësi për ushtrimin e së drejtës për të marrë pjesë dhe për të marrë vendime.
- ▶ Përgjegjësia dhe autonomia e shkollës për të definuar një proces në të cilin identifikohen pengesat në të mësuarit me të cilin përballen nxënësi dhe planifikimin e strategjive dhe masave të ndryshme për t'i tejkaluar të njëjtat.
- ▶ Përfshirja e prindërve/tutorëve - kanë të drejtë në pjesëmarrje dhe të informohen për të gjitha aspektet e procesit edukativo-arsimor të fëmijës së tyre.

III. QASJET PËR KRIJIMIN E NJË KLIME INKLUZIVE SHKOLLORE DHE PËRKRAHJE GJATË MËSIMIT

Parimet e mësipërme, në kontekstin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të përmbushen përmes zhvillimit dhe zbatimit të qasjes inkluzive në shkollë (Whole – school approach), që nënkupton ndërtimin e kapaciteteve në shkollë për zhvillimin e klimës inkluzive dhe sigurimin e mbështetjes sistematike për kuadrin e përgjithëm edukativo-arsimor.

Qasja gjithëpërfshirëse e shkollës përfshihet në dokumentet strategjike të shkollës dhe përmes saj përcaktohen hapat për ndërtimin e një klime inkluzive të shkollës. Qëllimi është arritja e respektit për dallimet, promovimi i barazisë, drejtësisë, mosdiskriminimit dhe krijimi i kushteve dhe mundësive për të mësuar dhe përparuar secili nxënës.

Efikasiteti i qasjes kryesisht varet nga:

- ▶ ekipet inkluzive të shkollës - përkushtimi i tyre për arsimin inkluziv, vizioni i përbashkët dhe gatishmëria për të punuar së bashku;
- ▶ klima e shkollës - demokratizimi në shkollë, transparencë ndaj ndryshimeve, aplikimi i risivenë procesin edukativo-arsimor;
- ▶ mbështetje nga organi udhëheqës dhe administrativ i shkollës.

Për ndërtimin e një shkolle inkluzive, nevojitet që procesi edukativo-arsimor të bazohet në modelin e ndërhyrjes për përkrahjen e me shumë niveleve. (Multi -tiered intervention model). Ky model përfshin transformime/ndërhyrje në planin mësimor dhe në programet mësimore, strategjitë mësimore, aktivitetet dhe materialet, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit të ndërhyrjeve, të paktën në tre nivele të përkrahjes së të mësuarit:

Niveli I - Mbështetje e përgjithshme

Për këtë lloj të mbështetjes vendoset nga shkolla në bashkëpunim me nxënësin dhe prindërit / tutorët dhe nuk ka nevojë për një vendim zyrtar. Mbështetja e përgjithshme sigurohet në nivelin e shkollës, dhe përveç mësimdhënësit, përfshihen bashkëpunëtorët profesionistë që mbajnë shënime për përparimin e nxënësit.

Të mësuarit duhet të synojë individualizimin dhe diferencimin e procesit mësimor duke aplikuar metoda dhe mjete të përshtatshme mësimore. Shpeshherë, për nxënësit me vështirësi në të mësuar, është mirë që mbështetja të synojë t'i ndihmojë ata të gjejnë stilin e tyre të mësuarit dhe praktikën përmes teknikave të ndryshme ndaj të mësuarit, megjithatë, në të njëjtën kohë punojnë në forcimin e përqendrimin edhe të kujtesës, por në një masë të madhe edhe për të aktivizuar proceset më të larta të mendimit, si dhe për të forcuar komponentën emocionale.

Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore shpesh kanë vështirësi në mësimnxëni që jo gjithmonë shkaktohen nga ndonjë formë e aftësisë së kufizuar. Duke pasur parasysh arsyet e vështirësive në mësimnxënie të këta nxënës, aktivitetet në shkollë duhet të synojnë në zbutjen dhe tejkalimin e tyre duke siguruar një mjedis stimulues për të mësuar dhe zhvillimin e potencialeve me të cilat disponojnë nxënësit.

Kjo do të thotë që edhe mbështetja individuale duhet të synojë përvetësimin e aftësive që do të zvogëlojnë pabarazinë fillestare dhe do të sigurohen kushte për inkurajimin dhe zhvillimin e potencialit me të cilat disponojnë nxënësit.

Bashkëpunëtorët profesionistë mund ta ndihmojnë nxënësin në zhvillimin e një imazhi pozitiv për veten dhe forcimin e vetëbesimit, zhvillimin e aftësive në të folurit dhe komunikimit, krijimin dhe zhvillimin e zakoneve për t'u kujdesur për veten dhe sigurinë e tyre, duke inkurajuar dhe zhvilluar bashkëpunimin me të tjerët dhe respektimin e

tyre, organizimi i mësimi dhe mënyrat e të mësuarit. Format e tjera të mbështetjes mund të planifikohen varësisht nga fakti nëse vështirësitë janë shkaktuar nga një lloj paaftësie ose janë për shkak të ndikimit të faktorëve që vijnë nga mjedisi i tyre i jetesës.

Niveli II - Mbështetje e intensifikuar

U ofrohet nxënësve në rast se mbështetja e përgjithshme nuk jep rezultatet e pritura. Një rekomandim për mbështetje të intensifikuar bëhet pas një vlerësimi të bërë nga ekipi inkluziv i shkollës dhe Organet profesionale për vlerësimin funksional. Mbështetja e intensifikuar është me ndërhyrje të shumëfishta dhe/ose të njëkohshme dhe i ofrohet nxënësit në bazë të planit arsimor individual.

Prandaj, ekipi i bashkëpunëtorëve profesionistë, pas vëzhgimit dhe identifikimit të kapaciteteve/ funksioneve ekzistuese të fëmijës, si dhe në fushat ku paraqiten vështirësi, duhet të bëjë një plan ndërhyrjeje në të cilin të gjitha aktivitetet do të mendohen mirë, do të bashkërenditen mirë edhe në funksionimin e përmirësimit të situatave, me qëllim përgatitjen e nxënësit për të mësuar dhe funksionuar më mirë në jetë, me ndërhyrje të hershme që ka një rëndësi të veçantë.

Niveli III - Mbështetja e veçantë

Sigurohet kur mbështetja e intensifikuar nuk plotëson nevojat e nxënësit ose në një rast tjetër, pasi të jetë bërë një rekomandim për mbështetje të veçantë pas një vlerësimi të bërë nga Organet e profesionistëve për vlerësimin funksional. Mbështetja e veçantë është e ngjashme me mbështetjen e intensifikuar, por me intensitet edhe më të madh dhe ndërhyrje të shumëfishta dhe/ose të njëkohshme dhe sigurohet në bazë të programit mësimor të modifikuar.

Të tre nivelet e mbështetjes sigurohen në shkollë të rregullta, në bashkëpunim me prindërit / tutorët, dhe në interesin më të mirë të mundshëm për nxënësit. Nëse mbështetja speciale e siguruar në shkollë nuk i plotëson nevojat e nxënësit, ekziston mundësia që mbështetja të sigurohet në shkollat fillore me një qendër burimesh ose qendra mbështetëse ndaj mësimnxënies. Format e mbështetjes përcaktohen në programin mësimor të modifikuar.

IV.

ZBULIMI I HERSHËM DHE NDËRHYRJET

Në zbulimin e hershëm të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, përveç prindërve të tyre dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor, rol kryesor kanë edhe organet profesioniste për vlerësimin funksional. Këto organe profesioniste vlerësimin funksional e bëjnë në përputhje me Klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit - KNF, miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në 2001.⁵ KNF bazohet në integrimin e modelit mjekësor dhe social të aftësisë së kufizuar dhe funksionimit. Në mënyrë që të arrihet integrimi i perspektivave të ndryshme të funksionimit, përdoret një qasje „biopsikosociale“ dhe aftësia e kufizuar shihet si një ndërveprim dinamik midis personit dhe faktorëve të mjedisit.

Sigurohet mbështetje plotësuese, pa diskriminim për asnjë arsye, për çdo fëmijë apo të ri që për shkak të çrregullimeve të zhvillimit, paaftësisë, çrregullimeve të sjelljes shoqërore, vështirësive në mësimnxënie, sëmundjeve kronike dhe arsyeve të tjera ka nevojë për mbështetje plotësuese në fushën e arsimit, shëndetësisë ose mbrojtjes sociale. Në bazë të vlerësimit funksional, përcaktohen mundësitë dhe nevojat e fëmijës ose të riut për përfshirje në institucionet parashkollore, në sistemin e rregullt edukativo-arsimor si dhe realizimi i të drejtave nga mbrojtja sociale, shëndetësore dhe punësimi, në përputhje me rregulloret ligjore.

⁵ Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit – KNF. Në dispozicion në: https://www.unicef.org/northmacedonia/sites/unicef.org.northmacedonia/files/2019-01/MK_SP_CWD_ICF_MK.pdf

Organet profesioniste për vlerësimin funksional kanë për detyrim të:

- të kryejnë vlerësime funksionale të fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje plotësuese në mjedise të ndryshme (në shkollë, në familje, në komunitet);
- të marrë një vendim zyrtar për llojin e mbështetjes, kontekstin e të mësuarit, akomodimin e nevojshëm të arsyeshëm dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme;
- japin rekomandime prindërve për një mbështetje sa më të mirë të mundshme të fëmijëve të tyre;
- në bashkëpunim me ekipin inkluziv të shkollës e ndjekin vazhdimisht të nxënit dhe rrethin e mësimnxënies, bashkërendisin mbështetjen dhe komunikimin ndërmjet prindërve, mësimdhënësve dhe personave profesionistë.

Në bazë të vlerësimit funksional të fëmijës ose të riut dhe familjes së tij/saj, mund të sigurohen masat që do t'i radhisim në vijim, bështetëse në fushën e edukimit dhe arsimimit:

- përparësi gjatë pranimet në institucionet parashkollore;
- realizimi i programeve parashkollore për punën me fëmijë me aftësi të kufizuara;
- arsim me mbështetje të intensifikuar;
- arsim me mbështetje të veçantë;
- shërbime të ndihmës arsimore;
- shërbime të ndihmës personale;
- puna individuale arsimore me një bashkëpunëtor profesional;
- punë këshilluese me fëmijën ose të riun;
- punë këshilluese me familjen;

- ▶ përdorimi i mjeteve të përshtatura dhe atyre ndihmëse poashtu edhe mjetet teknologjike; (përdorimi i mënyrave dhe mjeteve alternative të komunikimit - fotografi, vizatime, fotografi, objekte, përshtatja e orarit të orëve, mënyrë e veçantë e caktimit të vendeve në klasë, mënyrë e veçantë e caktimit të vendeve për materialin e punës, mënyrë e veçantë e caktimit të vendeve për punët e përfunduara, kompjutorë, përshtatje e tastierës, ekranet me prekje, përshtatje e miut, softueri special, kohëmatësit, rekorderëve etj.);
- ▶ sigurimi i trajnimit për nxënësit për përdorimin e alfabetit (kodi) Braille, lëvizjen e pavarur, përdorimin e teknologjisë ndihmëse, gjuhës së shenjave ose mjeteve të tjera alternative të komunikimit;
- ▶ tejkalimi i pengesave gjuhësore, si dhe mbështetja për fëmijët ku gjuha amtare është e ndryshme nga gjuha në të cilën nxënësi ndjek mësimet;
- ▶ organizimi i mbështetjes arsimore në rast të mungesës së zgjatur në shkollë për shkak të sëmundjes së rëndë dhe kronike, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësi në arsim, në formën e mësimdhënies së shtuar, mësimi në internet (online), punës individuale në spitale ose kushte të shtëpisë dhe angazhimit të profesionistëve me njohuri të specializuara;
- ▶ trajnimit i detyrueshëm i mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë që janë të përfshirë drejtpërdrejt në punën edukative-arsimore, në përputhje me parimet inkluzive, për përdorimin e teknologjisë ndihmëse, mjeteve alternative të komunikimit;
- ▶ sigurimi i transportit nga vendbanimi në institucionin arsimor;
- ▶ masa të tjera në përputhje me rregulloret ligjore pozitive.

Nevojitet avancimi në bashkëpunimin midis Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim të përmirësimit në mënyrë që të krijohet një mekanizëm për njohjen e hershme, parandalimin dhe identifikimin në kohë të çdo nevojë për mbështetje plotësuese për fëmijët **të moshës**

nga zero deri në gjashtë vjeç, si dhe sigurimin e informacionit dhe mbështetjes në kohë për prindërit/tutorët e fëmijëve.

Vlerësimi funksional dhe vlerësimi i nevojave të fëmijës për mbështetje plotësuese bëhet me kërkesë të prindërve/tutorëve të fëmijës dhe sipas detyrës zyrtare - me iniciativë të institucioneve në fushën e arsimit, shëndetit ose mbrojtjes sociale dhe ofruesve të shërbimeve sociale, me pëlqimin e prindërit ose tutorit.

Nëse prindi, përkatësisht tutori nuk pajtohen për të filluar një procedurë vlerësimi, dhe një vendim i tillë është i dëmshëm për fëmijën, me iniciativë të një individi ose institucioni, atëherë Qendra për Punë Sociale sipas detyrës zyrtare fillon procedurën në interesin më të mirë të fëmijës.

Përveç modelit të ndërhyrjeve mbështetëse në kuadër të shkollave, duhet të ndërtohet edhe një sistem i jashtëm mbështetës që do të jetë në dy nivele:

- ▶ rrjeti nacional / rajonal - për mbështetjen profesionale dhe qendrat burimore për zbatimin e arsimit inkluziv në shkolla (ndërtimi i kapaciteteve të shkollave dhe ekipeve inkluzive të shkollës) dhe
- ▶ lokale - mobilizimi i burimeve ekzistuese në mjedisin lokal, të rëndësishme për mbështetjen e arsimit inkluziv (vetëqeverisja lokale, qendrat mbështetëse, shërbimet, organizatat e shoqërisë civile), me qëllim që të shfrytëzohen plotësisht potencialet dhe mundësitë e tyre për mbështetjen dhe zbatimin e arsimit inkluziv.

V.

ZBULIMI I HERSHËM DHE NDËRHYRJET

Të gjithë faktorët e arsimit duhet të marrin pjesë në një bashkërenditje aktive në të gjitha fazat e zbatimit të proceseve të reformës në arsim (nga dizajni, përmes zhvillimit dhe zbatimit), në mënyrë që të sigurojnë programe mësimore inkluzive, tekste shkollore, vlerësime dhe burime të tjera të nevojshme për të arritur inkluzionin social. Inkluzioni nuk është vetëm një zgjedhje për politikëbërësit. Inkluzion, gjithashtu do të thotë një ndryshim në mendësinë (mënyrën e të menduarit) të shumicës në komunitet, duke përfshirë punonjësit e institucioneve që kanë nevojë për ta implementuar atë, përkatësisht krijimin e qëndrimeve dhe besimit se aftësitë nuk jepen njëherë e përgjithmonë dhe mund të zhvillohen përmes punës dhe punës në vetën e tij/saj. Në atë kuptim, sigurimi i arsimit inkluziv nuk është përgjegjësi e vetme e institucioneve arsimore⁶.

- **Mësimdhënësit** janë kryesorët për sigurimin e edukimit dhe arsimit cilësor për të gjithë fëmijët. Mësimdhënësit e trajnuar mirë, të mbështetur dhe të motivuar ndikojnë në qasjen, pjesëmarrjen dhe suksesin e të gjithë fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të cilëve u duhet inkurajim dhe mbështetje shtesë për të ardhur dhe qëndruar në shkollë.⁷

⁶ Global Education Monitoring Report 2020. Inclusion and Education: ALL MEANS ALL. Në dispozicion: <https://www.unesco.org/gemreport>

⁷ UNICEF: Mësimdhënësi, mësimi inkluziv dhe pedagogjia në qendër të së cilës janë fëmijët. Në dispozicion: https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4146/file/MK_ChildCentredTeaching_Report_MK.pdf

Mësimdhënësi inkluziv në punën e tij edukative-arsimore respekton parimet e mëposhtme:

- Arsimi inkluziv është përgjegjësi e të gjithë mësimdhënësve.
- Të gjithë mësimdhënësit vazhdimisht kanë nevojë për aftësi dhe njohuri të reja që duhet t'i marrin në mënyrë që të jenë në gjendje të zhvillojnë një kulturë bashkëpunuese shkollore dhe për të realizuar mësimdhënien në klasa inkluzive në përputhje me standardet ndërkombëtare për arsimin inkluziv.
- Arsimi inkluziv kërkon që mësimdhënësit vazhdimisht të mendojnë për mënyrën se si nxënësit mësojnë dhe marrin pjesë në klasë, shkollë dhe komunitet dhe si të marrin parasysh nevojat e ndryshme dhe stilet e mësimnxënies (vizuale, dëgjimore, lexim-shkrim dhe kinestetikë) të nxënësve.

Vlerat dhe qëndrimet e mësimdhënësve kanë rëndësi thelbësore për arsimin inkluziv. Mësimdhënësit, të cilët besojnë se janë përgjegjës për mësimin e të gjithë fëmijëve janë më efektivë në përgjithësi.

- **Institucionet parashkollore** - janë mjedise ku bëhet identifikimi i parë i disa fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe u ofrohet ndihmë prindërve për të inkurajuar zhvillimin e fëmijës dhe për të ofruar mbështetje shtesë. Ato lehtësojnë kalimin vertikal në arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe janë një burim i rëndësishëm i informacionit të nevojshëm për mësimdhënësit e shkollës fillore.
- **Shkollat** - (shkollat fillore dhe të mesme) - njohin dhe bëjnë përpjekje për t'iu përgjigjur nevojave të të gjithë fëmijëve dhe përmes parimeve të akomodimit të arsyeshëm krijojnë një mjedis stimulues shkollor për pjesëmarrjen dhe mësimin e secilit nxënës. Bashkëpunojnë dhe kultivojnë partneritete me prindërit / tutorët dhe me të gjithë faktorët përkatës të përfshirë në mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. Një nga rolet e rëndësishme të shkollave është njohja e aftësive të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe zhvillimi i tyre në individë të pavarur, konkurrues në tregun e punës. Shkollat mbajnë shënime, evidencë dhe kujdesen për të gjithë fëmijët që nuk janë regjistruar në shkollë dhe për nxënësit që nuk vijojnë shkollën në mënyrë të pajustifikuar.

- ▶ **Asistentë arsimor** - marrin pjesë në mësimdhënie në mënyra të ndryshme, gjithmonë nën mbikëqyrjen e mësimdhënësit, për të përmirësuar procesin e të mësuarit, nxënës. Ata mund të lehtësojnë punën në grupe me nxënës, duke punuar herë pas here individualisht me nxënës të caktuar në forcimin e aftësive të tyre, për të ndihmuar në menaxhimin në klasë (menaxhimi i disiplinës, motivimit, emocioneve dhe nevojave të nxënësit). Qëllimi i mbështetjes së dhënë nga asistentët arsimor është përmes bashkëpunimit me mësimdhënësit dhe duke zbatuar metodat e të mësuarit dhe mësimdhënies bashkëpunuese për të ndihmuar nxënës të marrin pjesë në procesin arsimor, për të realizuar potencialet e tyre dhe për të fituar pavarësinë dhe përfshirjen sociale në mjedisin shkollor.
- ▶ **Asistentët personal** – angazhohen në përkrahjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në kryerjen e aktiviteteve të përditshme. Qëllimi i mbështetjes së ofruar nga ndihmësi personal është t'iu ofrojë nxënës të kufizuar ndihmën e duhur individuale praktike në përmbushjen e nevojave themelore të jetës së përditshme: lëvizjen, mirëmbajtjen e higjienës personale, ushqimin, veshjen dhe komunikimin me të tjerët. Lloji i këtillë i mbështetjes i mundëson nxënës të fitojë një nivel më të madh pavarësie dhe funksionaliteti, si bazë për përfshirje më të lehtë në procesin edukativo-arsimor dhe aktivitetet e komunitetit.
- ▶ **Ndërmjetësuesit arsimor** - janë të angazhuar për fëmijët që vijnë nga mjedise të privuara nga shoqëria dhe për ata që janë jashtë sistemit edukativo-arsimor. Roli i ndërmjetësuesve është të informojnë për mundësitë dhe qasjen në shkolla, kryerjen e takimeve të rregullta për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës dhe personelit të shkollës fillore me specifikat dhe nevojat e grupeve të cënueshme në arsim, bashkëpunimin e rregullt me bashkëpunëtorët profesionistë dhe mësimdhënësit për të përmirësuar arritjet e nxënësve, ndërmarrja e aktiviteteve për të parandaluar braktisjen e parakohshme të nxënësve në procesin edukativo - arsimor. Nevoja për të punësuar një ndërmjetës arsimor bëhet me kërkesë të shkollës ku është regjistruar ose duhet të regjistrohet nxënësi, e cila dorëzohet në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Ndërmjetësit arsimorë angazhohen përmes thirrjes publike, të cilën e zbaton Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

- ▶ **Tutorë vullnetarë** - në përputhje me programin për sigurimin e kujdestarisë për nxënësit e shkollës fillore, të përcaktuar nga ministri, në mënyrë që të sigurojë mbështetje shtesë për nxënësit në lëndët që janë pjesë e planit mësimor në vitin shkollor në të cilin është regjistruar nxënësi, mundet përmes tutorit për mësimin e gjuhës mësimore për të kontribuar në tejkalimin e pengesës gjuhësore tek fëmijët, gjuha amtare e të cilëve është e ndryshme nga gjuha në të cilën zhvillohet mësimi.
- ▶ **Shkollat fillore të qendrës së burimeve** - me zhvillimin e inkluzionit, shkollat e veçanta (speciale) shndërrohen në shkolla të qendrave burimore dhe bëhen nacionale, përkatësisht qendra rajonale që do të ofrojnë burimet e tyre profesionale, materiale dhe hapësinore për nxënësit me aftësi të kufizuara, familjet e tyre dhe kuadrin edukativo-arsimor në shkolla. Ata do të kryejnë trajtim dhe rehabilitim individual, do të sigurojnë ndihmë arsimore dhe personale, do të marrin pjesë në zbatimin e një pjese të programit të modifikuar për nxënësit me nevoja komplekse, në përputhje me rekomandimin e trupit/organit profesional për vlerësimin funksional.
- ▶ **Qendrat e mbështetjes së mësimi** - me zhvillimin e inkluzionit, paralelet e veçanta në shkolla shndërrohen në qendra mbështetëse të mësimi dhe do të ofrojnë burimet e tyre profesionale, materiale dhe hapësinore për nxënësit me aftësi të kufizuara, familjet e tyre dhe stafin arsimor në shkolla. Ata do të kryejnë trajtim dhe rehabilitim individual dhe do të marrin pjesë në zbatimin e një pjese të programit të modifikuar për nxënësit me nevoja komplekse, në përputhje me rekomandimin e trupit ekspert për vlerësimin funksional.
- ▶ **Universitetet** - veçanërisht të rëndësishme për procesin e përfshirjes janë institucionet e arsimit të lartë që arsimojnë dhe prodhojnë kuadër mësimdhënës. Në mënyrë që të përmirësohen kompetencat e mësimdhënësve të ardhshëm dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, universitetet, përkatësisht fakultetet që trajnojnë stafin mësimdhënës do të bëjnë programe të reja studimi të harmonizuara me standardet ndërkombëtare për arsimin inkluziv. Universitetet, gjithashtu do të marrin pjesë në mbështetjen e mësimdhënësve në vendin e punës, përmes mësimi praktik me studentë në punëtoritë inkluzive.

- **Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)** - krijon politika inkluzive, siguron burime të përshtatshme shkollore (njerëzore, materiale dhe financiare) për zbatimin e arsimit inkluziv, ndjek praktikat inkluzive në secilën shkollë, burimet njerëzore të disponueshme dhe burimet e disponueshme në komunitet / komunë, në mënyrë që të sigurojë mbështetje shtesë për nxënësit që kanë nevojë për të.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të hartojë një strategji për transferimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga shkollat speciale në ato të rregullta dhe të mbështesë procesin e shndërrimit të shkollave speciale në shkolla me qendra burimore, i cili përfshin programin për zhvillimin e kapaciteteve të kuadrit që punon në ato shkolla.

- **Byroja e zhvillimit të arsimit (BZHA)** - angazhohet për promovimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, realizon kërkime zhvillimore në fushën e arsimit inkluziv, kryen punë këshillimore - profesionale për të mbështetur shkollat në pjesën e sigurimit të mësimin cilësor dhe siguron mjetet për regjistrimin, monitorimin dhe dokumentimin e progresit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore. BZHA punon në krijimin, akreditimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit në fushën e arsimit inkluziv, me qëllim trajnimin profesional të kuadrit arsimor dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve, botimin e manualeve, revistave dhe materialeve të tjera didaktike për të mbështetur mësimdhënien për të përmirësuar arsimin inkluziv.
- **Qendra për arsim dhe aftësim profesional dhe trajnim (QAAPT)** - roli i qendrës është të analizojë dhe studiojë sistemet e arsimit profesional, hartimin e zgjidhjeve të reja sistematike dhe konceptuale për nivele dhe lloje të caktuara të arsimit profesional, hulumtimin dhe propozimin e tregut të punës të profesioneve aktuale, zhvillimi i standardeve arsimore që përfshijnë konceptin e përfshirjes, mbështetjen e shkollave dhe partnerëve social për adaptimin dhe zbatimin e trajnimit praktik të nxënësve me aftësi të kufizuara, ngritjen e cilësisë së arsimit në shkollat profesionale me theks në arsimin inkluziv dhe përgatitjen e mësimdhënësve në shkollat profesionale për kryerjen e arsimit inkluziv.
- **Qendra shtetërore e provimeve (QSHP)** - përcakton dhe mundëson përshtatje në procesin e matjeve të jashtme të arritjeve të nxënësve dhe testimet shtetërore, në mënyrë që të plotësojë nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, jo vetëm në

aspektin e përshtatjeve teknike dhe mbështetjes, por gjithashtu në drejtim të personalizimit të përmbajtjes. QSHP në modulet e tij për trajnimin dhe licencimin e drejtorëve të ardhshëm të shkollave, do të ketë një modul/edhe për arsimin inkluziv dhe do të marrë parasysh rezultatet e arritura në këtë fushë, me rëndësi të veçantë.

- ▶ **Inspektorati shtetëror i arsimit (ISHA)** - si pjesë e vlerësimit të integruar, si dhe mbikëqyrje të jashtëzakonshme, monitoron dhe vlerëson praktikat inkluzive në secilën shkollë bazuar në treguesit e përcaktuar qartë që përfshihen në treguesit e cilësisë së shkollave. ISHA monitoron se si shkolla organizon dhe zbaton planin dhe programin mësimor, përkatësisht nëse zbaton në mënyrë efektive masa për të mbështetur procesin e mësimnxënies.
- ▶ **Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - (MPPS)** - monitoron dhe promovon punën e parashkolloreve, qendrave të kujdesit ditor dhe institucioneve të tjera sociale që ofrojnë mbështetje për shkollat, përmes shërbimeve të saj. Përmes qendrave rajonale për punë sociale, MPPS merr pjesë në procesin e zbulimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, të cilët janë jashtë arsimit. Kjo ministri siguron gjithashtu licencimin e shërbimeve që ofrojnë shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara.
- ▶ **Organet eksperte për vlerësimin funksional** - kanë një rol për të kryer vlerësimin funksional në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit - KNF, fëmijë ose të rinj që kanë nevojë për mbështetje shpesh, për të marrë një vendim zyrtar për llojin e mbështetjes, kontekstin e të mësuarit, për të dhënë rekomandime për prindin se si ta mbështesin fëmijën dhe për të monitoruar vazhdimisht mjedisin e të mësuarit dhe mësimnxënies dhe për të bashkërenditur mbështetjen dhe komunikimin midis prindërve, mësimdhënësve dhe profesionistëve.
- ▶ **Vetëqeverisja lokale** - monitoron dhe mbështet procesin e arsimit inkluziv në nivelin lokal, mbështet bashkëpunimin ndërministror, ofron shërbime në nivelin lokal për të promovuar përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Vetëqeverisja lokale afirmon konceptin e përfshirjes në një nivel më të lartë, e përfshin atë në planet e saj të veprimit dhe ndërmerr aktivitete për sensibilizimin e mjedisit më të gjerë lokal në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, është përgjegjës për përmirësimin e qasjes fizike të shkollave, por edhe të të gjitha mjediseve publike të hapura për popullatën e përgjithshme

dhe kujdeset për përfshirjen e të gjithë fëmijëve nga komuna e saj në procesin arsimor. Vetëqeverisja lokale ka një rol kryesor në përcaktimin e rajoneve dhe në zbatimin efektiv të rajonalizimit, si parakushte për integrimin e fëmijëve nga bashkësitë e ndara.

- ▶ **Organizatat qytetare** - aktualizojnë çështjen e inkluzionit, përfaqësojnë dhe llobojnë për interesat e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe familjeve të tyre. Këto organizata ofrojnë mbështetje për shkollat dhe prindërit/tutorët e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në nivelin lokal, nacional dhe të njëjtat i mbështesin në ushtrimin e të drejtave dhe mundësive të tyre.
- ▶ **Shërbimet** - janë të specializuar dhe të licencuar në fushën e ofrimit të shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe familjet e tyre. Shërbimet ofrojnë shërbime këshillimi për prindërit dhe i udhëzojnë ata në procesin e ndërmarrjes së hapave të nevojshëm për të mbështetur fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Këto shërbime janë nën kompetenca të MPPS.
- ▶ **Qendrat e kujdesit ditor** - me ekspertizën dhe kompetencat e tyre ofrojnë mbështetje për shkollat, dhe kanë mundësinë dhe nevojën për të krijuar shërbime të reja në nivelin lokal për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe familjet e tyre dhe ata janë nën juridiksionin e MPPS.

VI.

REGJISTRIMI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR, FILLOR DHE TË MESËM

Regjistrimi i fëmijëve në institucionet parashkollore është thelbësor për përfshirjen e tyre të suksesshme sociale gjatë gjithë jetës. Për të mundësuar regjistrimin në kohë dhe rritjen e përfshirjes së fëmijëve të lindur me rrezik dhe aftësi të kufizuara në zhvillim, fëmijë nga kategori të ndryshme të prekshme, në institucionet parashkollore, është e nevojshme të merren masat e mëposhtme: përparësia në regjistrim, sigurimi i subvencioneve financiare për regjistrim, sigurimi i personave mbështetës kompetentë (pedagog, psikolog, edukator special dhe rehabilitues, logoped, punonjës social, etj.).

Institucionet parashkollore do të mbështesin fëmijët me nevoja të veçanta duke përshtatur mënyrën e punës për secilin fëmijë, dhe duke siguruar kështu pjesëmarrjen e tyre aktive në aktivitete të përshtatshme të bazuara në lojë.

Komisioni shkollor për regjistrimin e një fëmije në klasën e parë merr informacionin kryesor për të nga prindërit / tutorët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të fëmijës së tyre dhe të marrin vendime të rëndësishme në jetën e fëmijës, përfshirë arsimin formal dhe joformal.

Vlerësimi fillestar që bëhet në shkollë bazohet në burime dhe metoda të ndryshme (biseda, vëzhgimi i fëmijës në situata dhe mjedise të ndryshme, vlerësimi themelor i funksionaliteteve - aftësitë motorike, vëmendja dhe përqendrimi, pranimi i përpjekjeve, komunikimi, perceptimet, gjendja emocionale), pra merren të dhëna për gjendjen fillestare për sa i përket pikave të forta / potencialeve si dhe nevojave për mbështetje të fëmijëve.

Gjatë regjistrimit të fëmijës me aftësi të kufizuara në klasën e parë, nga prindi /tutori kërkohet të paraqesë një mendim/profil funksional nga një organ profesional për vlerësimin funksional. Nëse komisioni shkollor për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë vlerëson se fëmija ka disa vështirësi funksionale, dhe prindi/tutori nuk ka paraqitur një mendim/profil funksional nga një organ profesional për vlerësimin funksional, është në interesin më të mirë të fëmijës që ta udhëzojë prindin/tutorin në organin profesional për vlerësim, në mënyrë që të marrin informacionin dhe udhëzimet përkatëse për masat e nevojshme të mbështetjes.

Në periudhën e mëtejshme të arsimimit të fëmijës, nëse ekipi inkluziv i shkollës përcakton se nxënësi ka nevojë për mbështetje plotësuese në procesin edukativo-arsimor, ekipi mund të rekomandojë prindin/tutorin që ta çojë fëmijën për një vlerësim funksional në organin profesional për atë qëllim. Gjatë udhëzimit, EISH përpilon mendimin për vështirësitë me të cilat përballlet nxënësi.

Nëse prindi refuzon të fillojë procedurën, dhe është në interesin më të mirë të fëmijës, shkolla sipas detyrimit zyrtar fillon procedurën.

Për mbledhjen sa më efkase dhe gjithëpërfshirëse të informacionit përkatës me qëllim vlerësimin fillestar dhe njohjen më të mirë me fëmijën, veçanërisht kontribuon bashkëpunimi i shkollës fillore me institucionet parashkollore përmes shkarkimit të detyrueshëm të dokumentacionit (dosje e zhvillimit) për fëmijën prej tyre. Kjo mundëson monitorimin dhe vlerësimin e zhvillimit dhe progresit të secilit fëmijë dhe krijon një mundësi për planifikimin në kohë të masave mbështetëse që secili fëmijë duhet të marrë.

Ky lloj bashkëpunimi ka rëndësi të veçantë në kalimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore nga mësimi klasor në mësimin lëndor, si dhe nga arsimi fillor në atë të mesëm, ku ekipet inkluzive të shkollës fillore dhe të mesme duhet të sigurojnë të gjitha informacionet përkatëse për nxënësin në mënyrë të sigurt dhe një mënyrë konfidenciale për tu transmetuar. Në atë mënyrë, ekipi inkluziv për nxënësin që do të formohet në shkollën e mesme do të jetë në gjendje të vazhdojë procesin edukativo-arsimor në një mënyrë në interesin më të mirë të nxënësit.

Shkolla, gjithashtu mund të kontaktojë dhe të bashkëpunojë me institucione dhe organizata të tjera në aktivitetet/programet ku përfshihet fëmija.

VII.

PËRGATITJA E NXËNËSVE PËR MUNDËSITË E OFRUARA TREGU I PUNËS

Tranzicioni është një proces që duhet të sigurojë pjesëmarrjen aktive të nxënësit dhe respektimin e zgjedhjes së tij/saj në vendimmarrje. Të gjithë faktorët e përfshirë në procesin edukativo-arsimor duhet të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë një plan individual të tranzicionit (PIT) për zhvillimin e mëtejshëm të nxënësit pas përfundimit të një niveli të caktuar arsimor, brenda programit vjetor të punës së shkollës.

Zhvillimi i planit individual të tranzicionit dhe krijimi i një portfolio për orientim profesional, këshillim dhe trajnim profesional duhet të fillojë me përfshirjen e nxënësit në procesin edukativo- arsimor. Zbatimi i vlerësimit përshkrues dhe analizës plotësuese në ndjekjen/monitorimin e vazhdueshëm të zhvillimit të nxënësit dhe të arriturve të tij do të japë udhëzime, kahe për këshillim në karrierë, trajnim profesional dhe konkurrencë në tregun e punës. Procesi përfshin mbledhjen e informatave, vizita e vendeve të punës, mendimin dhe marrjen e vendimeve për jetën pas përfundimit të shkollës. Shkolla duhet t'i sigurojë të gjithë mbështetjen e nevojshme nxënësit për të qenë në gjendje të marrë një vendim të shëndoshë dhe të informuar për mundësitë që do të vendosen pas përfundimit të shkollës, bazuar në pritjet personale për jetën e tyre në shoqëri, me përfshirjen e duhur profesionale, sociale dhe familjare.

Zhvillimi i PIT duhet të udhëhiqet nga fakti që planifikimi për secilin person bëhet individualisht, duke ndjekur parimet e arsimit universal të të rinjve, barazinë, përfshirjen, fleksibilitetin dhe vetëvendosjen.

Qëllimi përfundimtar i arsimit inkluziv është të sigurojë përfshirjen e plotë të personave me nevoja të veçanta arsimore në „botën e punës për të rritur“. Për të arritur një qëllim të tillë, është e nevojshme:

- ▶ Të gjitha veprimtaritë arsimore duhet të synojnë ndërtimin e kompetencave kryesore të nxënësit për mësimin e përjetshëm;
- ▶ Këshillimi i karrierës për të gjithë pjesëmarrësit duhet të fillojë nga arsimi fillor. Nxënësit me NVA duhet të përfshihen në programet e udhëzimit profesional që do të zhvillojnë aftësi për vetëpërfaqësim në tregun e punës;
- ▶ Vendorsja e partneriteteve të ngushta ndërmjet shkollave dhe kompanive në mënyrë që të lehtësohet procesi i kalimit nga arsimi në punësim dhe të krijohen kushte, përmes rregullimit të arsyeshëm, për të përfshirë personat me nevoja të veçanta arsimore në procesin e punës, mbi një bazë të barabartë me të gjithë.

VIII.

SIGURIMI I KUSHTEVE PËR ARSIMIN INKLUZIV (GJITHPËRFSHIRËS)

ROLI I EKIPEVE TË INKLUZIONIT NË SHKOLLA

Për zhvillimin e arsimit më cilësor për të gjithë fëmijët, dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në shkolla formohen dhe punojnë dy lloje të ekipeve inkluzive:

- ▶ **Ekipi inkluziv i shkollës,** i formuar nga drejtori i shkollës, përbëhet nga shtatë anëtarë: pedagog, përkatësisht psikolog, punonjës social, dy mësimdhënës nga të punësuarit në shollë, dy prindër/ tutorë, edukator special dhe rehabilitues dhe drejtori i shkollës. Nëse shkolla nuk ka një bashkëpunëtor profesional të një profili të caktuar, emërohet një person nga shkollat me një qendër burimesh ose nga qendrat përkrahëse të procesit mësimor. Ekipi inkluziv i shkollës kujdeset për politikën dhe praktikën inkluzive në nivelin e shkollës në tërësi, harton dhe zbaton aktivitetet e planifikuara dhe kujdeset që ato të harmonizohen dhe zbatohen në punën edukative-arsimore.
- ▶ **Ekipi inkluziv i nxënësit,** formohet nga drejtori i shkollës dhe përbëhet nga: mësimdhënësit e nxënësit, prindi / tutori, pedagogu, pra psikologu, ose punonjësi social në shkollë dhe edukatori special dhe rehabilituesi. Nëse shkolla nuk ka një bashkëpunëtor profesional të një profili të caktuar, emërohet një person nga shkollat me qendër burimesh ose nga qendrat që përkrahin procesin mësimor. Ky ekip, nëse është e nevojshme,

mund të përfshijë persona të tjerë që mbështesin nxënësin (mjek, një lloj bashkëpunëtori tjetër profesional ose rehabilitues me të cilin nxënësi punon jashtë shkollës), si dhe një ndihmës arsimor ose asistent personal, nëse i njëjti rekomandohet nga trupi/organi i ekspertëve për vlerësimin funksional dhe punon me nxënësin. Ekipi inkluziv i nxënësve në fokusin e punës së tij ka konkretisht nxënësin për të cilin është formuar ky ekip, përkatësisht zbaton masat për mbështetje në mësim në përputhje me rekomandimet e organeve profesionale për vlerësimin funksional. Sa i përket kësaj, nëse rekomandohet, ekipi i nxënësve të shkollës përgatit një PAI për nxënësin me aftësi të kufizuara, në përputhje me potencialet dhe nevojat individuale të tij/saj dhe punon me nxënësin sipas tij/saj.

PROGRAMET DHE PLANET SHKOLLORE

Shkollat, në bazë të një vetëvlerësimi paraprakisht të bërë, përgatisin një program zhvillimi për punën e shkollës për një periudhë katër vjeçare, në bazë të të cilit përgatitet një program vjetor për punën e shkollës çdo vit shkollor. Këto dokumente duhet të përmbajnë informacion mbi gjendjen e arsimit inkluziv në shkollë, si dhe udhëzime, masa dhe aktivitete se si të përmirësohen vazhdimisht proceset inkluzive. Masat, të cilat më pas shtjellohen në planet e veprimit, kryesisht përfshijnë segmentet e mëposhtme:

- ▶ ndërtimi i kapaciteteve të shkollës dhe mësimdhënësve për inkluzion, edukim dhe arsimim të suksesshëm të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (sigurimi i kushteve fizike, organizative, dhe parakushtet profesionale dhe procedurale për arsimin inkluziv dhe planifikimi në kohë i qasjes së fondeve për të njëjtën);
- ▶ punë me nxënësit, mësimdhënësit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe prindërit për të ndërtuar dhe kultivuar një klimë inkluzive (gjithëpërfshirëse) në shkollë;
- ▶ rritja e kompetencave profesionale të mësimdhënësve për zbatimin e qasjeve interaktive në mësimdhënie, vlerësimin pedagogjik të nxënësve, si dhe mësimdhënien e individualizuar;

- ▶ sendërtimi i bashkëpunimit me prindërit, shoqatat përkatëse dhe institucionet në bashkësinë lokale (administrata komunale, shëndetësia dhe mbrojtja sociale) për realizimin e suksesshëm të arsimit inkluziv, si dhe për ngritjen e vetëdijes publike për rëndësinë e tij.

MJEDISI FIZIK DHE PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË

Qasja në arsim nënkupton edhe përshtatjen me mjedisin fizik, përkatësisht heqjen e pengesave që mund të pengojnë ose vështirësojnë funksionimin e nxënësit në mjedisin shkollor. Për këtë qëllim, shkollat si dhe shkollat me qendër burimesh dhe vetëqeverisja lokale kujdesen për:

- ▶ Heqjen e pengesave arkitektonike, me çka sigurohet hyrjen në ndërtesën e shkollës dhe të gjitha hapësirat për nxënësit, prindërit dhe mësime ndihmësit me çfarëdo forme të aftësisë së kufizuar fizike ose shqisore;
- ▶ Përshtatjen e orendive dhe pajisjeve në klasë sipas nevojave të veçanta të nxënësve;
- ▶ Përshtatjen e një pjese të tualeteve për nevojat e veçanta të nxënësve;
- ▶ Sigurimin e planeve, caktimin/shënimin e drejtimit të lëvizjes dhe shiritat e lehtësimit për një orientim më të lehtë në hapësirë;
- ▶ Furnizimin e teknologjisë ndihmëse (mësimore dhe mjete të tjera ndihmëse) për heqjen e pengesave në arsimin inkluziv të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.
- ▶ Në procesin e mbështetjes së arsimit inkluziv, një mjet i rëndësishëm është teknologjia e informimit-komunikimit që mundëson:⁸
- ▶ Nxënësit të përdorin në mënyrë efektive TIK në procesin e të mësuarit, me ërast përkrahjet pjesëmarrja përmes formave të individualizuara të punës mësimore, për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

⁸ European Agency for Special Needs and Inclusive Education. Достапно на: <https://www.european-agency.org/sites/default/files/Information%20and%20Communication%20Technology%20for%20Inclusion.pdf>

- Mësimdhënësit të përdorin në mënyrë efektive TIK për të mbështetur të mësuarit në një mjedis inkluziv, i cili kërkon zhvillim të vazhdueshëm profesional për zbatimin e teknologjisë, brenda dhe jashtë shkollës.

Për realizimin e disa prej aktiviteteve që duhet të ndërmerren, dhe për të cilat është e nevojshme mbështetje plotësuese financiare dhe tjetër e shkollës, ajo mund të sigurohet brenda aktiviteteve të ndryshme: arsimit, mbrojtja sociale, shëndetësia. Mbështetje plotësuese financiare dhe mbështetje tjetër të siguruara dhe të bashkërenditura kryesisht nga qeveria lokale dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

KOMPETENCAT E MËSIMDHËNËSVE DHE RËNDËSIA E MBËSHTETJES MES MOSHATARËVE

Mësimdhënësit kanë një rol thelbësor në jetën e nxënësve. Ekzistimi një qëndrimi pozitiv ndaj të gjithë nxënësve dhe gatishmëria për të bashkëpunuar me persona të tjerë profesionistë, konsiderohen si parime themelore në procesin mësimor. Të gjithë mësimdhënësit duhet të jenë të përkushtuar në procesin e të mësuarit të të gjithë nxënësit për të fituar shkathtësitë e shekullit XXI: shkrim-leximi dixhital, shkathtësi komunikimi, shkathtësi marketing dhe shitje, pranimi i shpejtë dhe i sigurt i ndryshimit, inteligjencë emocionale, aftësi për punë ekipore. Gjatë arsimit fillestar (inicial) dhe të vazhdueshëm, mësimdhënësit duhet të zhvillojnë aftësitë e duhura për të përmbushur nevojat e ndryshme të nxënësve. Prandaj, mësimdhënësit duhet të marrin përgjegjësinë për mësimin e tyre gjatë gjithë jetës.

Agjencia Evropiane për nevoja të veçanta dhe arsimin inkluziv⁹ identifikoi disa qasje efektive në mësimdhënie për nxënësit që mësojnë në klasa heterogjene në raport të kompetencave të kuadrit edukativo-arsimor (qëndrimet dhe besimi, njohuritë, shkathtësitë dhe gatishmëria).

